

Teknik i Kontabilitetit

Formular për paraqitjen e provimeve



ShKÇAK
DKRRK
SCAAK

SHOQATA E KONTABILISTËVE
TË CERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE
TË KOSOVËS

DRUSTVO KVALIFIKOVANIH
RACUNOVODJA I REVIZORA
KOSOVA

SOCIETY OF CERTIFIED
ACCOUNTANTS AND AUDITORS
OF KOSOVO

Emri dhe mbiemri _____ Nr. ShKÇAK

--	--	--	--

P1/Kontabilitet Financiar _____

P2/Kontabiliteti menaxherial dhe i kostos _____

P3/Kontabilisti në biznes _____

P4/Ligjet dhe tatimet në Kosovë _____

Numri i provimeve të paraqitura _____

JU LUTEMI SHENONI ME
PROVIMIN QE JENI DUKE
E PARAQITUR

Data: _____

Nënshkrimi _____

Pjesa në vazhdim plotësohet nga ShKÇAK, ju lutemi mos shenoni asgjë

	I paguar	I anuluar
Kontabiliteti Financiar	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Kontabiliteti menaxherial dhe i kostos	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Menaxhmenti dhe komunikimet	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Ligjet dhe tatimet në Kosovë	<input type="text"/>	<input type="text"/>

	Anëtarësimi
I paguar	<input type="text"/>
I papaguar	<input type="text"/>
I padefinuar	<input type="text"/>

UDHËZIME PËR HYRJE NË PROVIM

Provimet në ShKÇAK mbahen tre herë në vit.

Paraqitja e provimeve bëhet në afatin e publikuar në web faqen e ShKÇAK.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË PROVIM

- Plotësimi i formularit për paraqitje të provimit;
- PAGESA e provimit; dhe
- PAGESA e anëtarësisë vjetore.

Me qëllim të eliminimit të çfarëdo paqartësie në ditën e mbajtjes së provimit, luteni që të keni kujdes lidhur me kushtet e cekura më lartë.

MUNGESA NGA PROVIMI - PA PARALAJMËRIM

Në rastet kur e keni paraqitur provimin/et por në ditën e mbajtjes së provimit nuk keni qenë prezent do të konsiderohet se keni munguar nga provimi. Në këto raste nuk do të keni të drejtë në kthim të shumës së paguar për provim.

MUNGESA NGA PROVIMI - ME PARALAJMËRIM

Në raste kur e keni paraqitur provimin/et por më vonë e keni bërë kërkesën për anulim (së paku 7 ditë para provimit) shumë e paguar për atë provim do të mund ta shfrytëzoni VETËM për njërin nga 2 afatet e rradhës dhe vetëm për të njëjtin provim.

PROVIMI

Provimet fillojnë përgjithësisht në ora 09:00 përveç nëse caktohe ndryshe.

Provimet mbahen në Sh.F. "Dardania" në Prishtinë.

Për çdo ndryshim do të informoheni me kohë.

Kujdesuni që të mbërrini në vendin e mbajtjes së provimit së paku 15 minuta para kohës së përcaktuar për fillimin e provimit.

UDHËZIME PËR PROVIM

Provimet janë me shkrim kurse kohëzgjatja është 3 orë.

Për çdo provim do t'i keni në dispozicion 15 minuta shtesë për lexim dhe planifikim të kohës.

Koha shtesë është lejuar me qëllim që tu mundësojë kandidatëve t'i lexojnë pyetjet dhe ta planifikojnë kohën para se të fillojnë me dhënien e përgjigjeve. Kjo kohë do shërbejë për tu siguruar se të gjitha informatat dhe kërkesat e provimit janë lexuar dhe kuptuar në mënyrën e duhur. Kandidatët nuk do të shkruajnë asgjë në fletëprovimet e tyre pa lejen e mbikqyrësit të provimit. Në fletëprovim do ta shkruani vetëm numrin e kartelës së ShKÇAK.

DISA RREGULLA PËR PROVIM

- Në raste specifike mund të tolerohet vonesa deri në 30 minuta pas fillimit të provimit por kjo nuk nënkupton edhe zgjatjen e kohës së provimit.
- Për të marrë pjesë në provim duhet ta keni me vehte kartelën e ShKÇAK dhe letërnjoftimin të cilat do ta mbani me vehte gjatë tërë kohës së provimit.
- Gjësendet tuaja personale para hyrjes në provim do t'i lini jashtë sallës së provimit.
- Në sallën e provimit ndalohet rreptësisht përdorimi i telefonave celular.
- Në sallën e provimit dhe objektin ku gjendet salla ndalohet pirja e duhanit.
- Me vehte do të merrni vetëm stilolapsa kurse kalkulatorët do të sigurohen nga ShKÇAK.
- Në sallën e provimit nuk lejohet të përdorni libra, shënime apo materiale tjera.
- Gjatë mbajtjes së provimit nuk lejohet të merrni apo t'i jepni kurfarë ndihme kandidatit tjetër.
- Nuk lejohet të dilni nga salla e provimit në 30 minutat e para dhe 20 minutat e fundit të provimit.
- Çdo herë kur dilni nga salla e provimit duhet të merrni leje nga mbikqyrësit të provimit.

Lutemi që gjatë tërë kohës sa zgjat provimi tu përmbaheni udhëzimeve të dhëna nga mbikqyrësi.

PUBLIKIMI I REZULTATEVE

Rezultatet e provimeve do t'i dërgohen me email secilit kandidat që ka paraqitur provimin në afatin e përcaktuar nga SHKÇAK. (pas përfundimit të sesionit të provimeve).

RISHIKIMI I REZULTATIT TË PROVIMIT

Pas publikimit të rezultateve të provimit ju mund të paraqitni kërkesë për rishikim të provimit/ve. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 5 ditëve të punës nga dita e publikimit të rezultateve kurse përgjigjen do ta merrni më së largu 10 ditë pune nga përfundimi i afatit për paraqitjen e kërkesave.

Gjatë rishikimit të provimit nga komisioni NUK lejohet prezenca e parashtruesit të kërkesës.

Me nënshkrimin tim konfirmoj se i kam lexuar dhe kuptuar informatat dhe rregullat e mësipërme lidhur me provimet me të cilat pajtohem në tërësi dhe njëherit deklaroj se do ta rrespektoj Statutin e ShKÇAK, Kodin Etik të IAB, FNK - ShKÇAK dhe Rregullat e Mirësjelljes Profesionale.

Nënshkrimi i Studentit _____